



KOMITETI PËR KOMUNITETE

Kuvendi Komunal-Junik
Nr. 02/02/23
Datë: 24. 03. 2023, ora 10⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbi Mbledhjen Dytë të Rregullt të Komitetit për Komunitete, mbajtur me datën 24 Mars 2023, në orën 10⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Komiteti si në vijim:

1. Zejnepe Gaxherri - kryesuese, përfaqësuese (LDK),
2. Zenel Maloku - përfaqësues (AAK),
3. Eliza Pepshi - përfaqësuese (LVV), dhe
4. Valdrin Isufaj - përfaqësues (Komuniteti i Biznesit), dhe
5. Safete Shehu - përfaqësuese (OJQ Qershiza).

Poashtu i pranishëm në këtë mbledhje ishte edhe drejtori për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis z. Zenun Shala.

Mbledhjen e Dytë të Rregullt të Komitetit për Komunitete e kryesoj znj. Zejnepe Gaxherri e cila përshëndeti të pranishmit, si dhe prezantoi dhe kërkoi miratimin e Rendit të Ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Projektet për infrastrukturë në lagjet dhe fshatrat me komunitete gjatë vitit 2023,
3. Siguria e nxënësve të shkollës fillore dhe të mesme,
4. Të ndryshme.

Ky Rend i Ditës u shqyrtua dhe me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika e Parë e Rendit të Ditës
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesja znj. Zejnepe Gaxherri kërkoj shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit, i cili shqyrtua dhe me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika Dytë e Rendit të Ditës
Projektet për infrastrukturë në lagjet dhe fshatrat me komunitete gjatë vitit 2023

Lidhur me këtë fjalën e kërkoj znj. Safete Shehu ndërsa tha, unë poashtu kërkoj që rruga nga lagja “Agim Ramadani” deri në Qendër të Junikut të rregullohet, dhe u ankua se asamblastët nuk po punojnë sa duhet në adresimin e kërkesave dhe nevojave të qytetarëve për realizimin e këtyre projekteve.

Z. Zenel Maloku tha, ne në Kuvend kemi bërë kërkesë që të ndreqet Qendra e Juniku, mirëpo ne asamblastët nuk mund t’i realizojmë këto projekte.

Ndërsa, lidhur me këtë pikë të Rendit të Ditës drejtori për Urbanizëm z. Zenun Shala tha, unë para disa ditëve kam marrë një kërkesë nga ju dhe kam përgatitur këtu disa projekte të cilat planifikohen që të kryhen këtë vit, dhe këto janë: Rregullimi i kanalizimit në lagjet Miroc-Gaxherr-Qendër; hapja dhe rregullimi i rrugës fushore Troja; hapja e rrugëve fushore në Gjocaj; kanalizimi i lagjeve Moronicë-Qok-Bajraktar; ndërtimi i kanalit të ujitjes Topilla; ndërtimi i urës së lumit Erenik që lidh rrugën Junik-Jasiq; hartimi i planit ideor për dizajnimin e Qendrës së Junikut; hartimi i detyrës projektuese dhe tenderimi për projektin ideor të Qendrës së Juniku, dhe punimi i kanaleve të ujitjes në gjatësi 4 km në të gjitha lagjet e Junikut, përfshirë edhe ujëmbledhësin e Travës në zonën kadastrale Llugat e Begut, ky donacion i Ministrisë së Bujqësisë. Tenderi ka dalë vitin e kaluar, ndërsa ekzekutimi do të bëhet këtë vit.

Fondin për këto kanale është i Ministrisë së Bujqësisë, ndërsa ne marrim pjesë vetëm me një ndihmës-menaxher të projektit.

Pra, këto janë dhjetë investimet tona. Ndërtimi i urës së lumit Erenik është bashkëfinancim me Ministrinë e Pushteti Regjional, dhe punimi i kanaleve të ujit që është donacion nga Ministria e Bujqësisë, të gjitha të tjerat janë vetëfinancim nga Komuna.

Z. Zenel Maloku tha, unë kam një kërkesë për furnizim me ujë të pijes në lagjen “Agim Ramadani”, ku janë sjellë vetëm dy kroje, ndërsa ky ujë ka erë dhe shije të

keqe, pra ky ujë nuk pihet. Neve na duhet t'i vijmë prapë në Junik që të furnizohemi me ujë të pijes.

Unë kërkoj që të hapet një kanal prej lokalit "Oda" deri në lagjen "Agim Ramadani", të hynë gypat e ujit dhe të lidhen me ato kroje. E kuptoj që ju jeni munduar të kurseni para, mirëpo ajo punë nuk dal mirë, ka dal keq. Këto unë do t'i paraqes edhe në Kuvend.

Z. Zenun Shala tha, kjo është bërë në kushte emergjente vitin e kaluar. Ju mund të bëni kërkesë për këtë, dhe ne do t'i përgjigjemi kësaj kërkesë.

Znj. Safete Shehu tha, qëllimi është që asamblastët të ngritin zërin në Kuvend, që ky ujë të arrij në lagje, dhe të jete i pijshëm dhe i sigurt.

Z. Zenel Maloku tha, këtë çështje e kemi ngrit në Kuvend shumë herë dhe kemi patur premtime se do të kryhet, por asnjëherë nuk është kryer, dhe kjo është premtuar për 12 vite rresht nga qeverisja e kaluar, mirëpo kjo çdoherë ka dal të jetë gënjeshtër, dhe njëjtë po bëhet edhe në qeverisjen e tanishme. Neve na duhet uji i pijes.

Tjetër, është pyetja për rrugët lokale Jasiq dhe Gjocaj të cilat nuk janë ta shtruara me asfalt. A janë në projekt për t'u shtruar, pyeti z. Maloku?

Z. Zenun Shala tha, jo ato nuk janë në projektet këtij viti.

Pika Tretë e Rendit të Ditës **Siguria e nxënësve të shkollës fillore dhe të mesme**

Z. Valdin Isufaj tha, se në shkolla ka patur mungesë të druve për nxehje, por ka qenë fat i mirë se dimri ka qenë i butë.

Znjsh. Eliza Pepshi poashtu tha edhe vitin e kaluar ka qenë i njëjti problem, pra ka patur mungesë të druve për djegie në Shkollën Fillore dhe në Gjimnaz.

Z. Zenel Maloku tha, unë do ta ngriti edhe këtë çështje në mbledhjen e radhës së Kuvendit. Vitin e kaluar këta si Komunë i kanë vjedhë drutë. Unë i kam thënë drejtorit të Arsimit, drutë që i keni marrë herën e fundit në zonën e parkut, a janë marrë me letër apo pa letër? Nëse janë marrë me letër tregona letrën, sepse rampa nuk guxon të lëshoj dru pa letër, ndërsa juve ua paska lëshuar. Kjo i bie vjedhje nga ana e Komunës në prezencë të policisë, sipas burimeve të sakta. Kjo është punë e çoroditur që nuk ka ndodh që 50 vite. Drejtori tha unë nuk po kuptoj dhe nuk me dha sqarim.

Pra, fjala është që vitin e kaluar janë vjedhë 300 m³ dru në mal, pa letra, dhe për këtë duhet të ketë patur njohuri edhe policia.

Tjetër, nxënësi janë të rrezikuar gjatë udhëtimit nga tre persona, që janë; kryetari i Komunës, drejtori i Shërbimeve Publike, dhe komandanti i Policisë. Pra, këta i rrezikojnë të gjithë nxënësit e Junikut, dhe është mirë që të merren masa ndaj tyre. Së pari të lajmërohen Prokuroria, dhe Inspektorati Policor i Kosovës, të cilët duhet të merren me ta.

Poashtu, trotuaret janë të zëna, shenja të komunikacioni nuk ka të vendosura, dhe kanë gënjyer se i kanë vendosur ato. Pra, të gjitha këto janë duke u bërë nga këta persona. Unë mbi dhjetë herë kam bërë kërkesë për këtë, mirëpo nuk janë ndërmarr asfarë masash lidhur me këto kërkesa.

Përpos makinave, trotuaret janë të zëna edhe me tavolina para restoranteve, ndërsa unë kërkoj që të merren masa ndëshkuese nga prokuroria dhe organet tjera relevante.

Pika Katërt e Rendit të Ditës Të ndryshme

Znj. Safete Shehu ngriti çështjen e vazhdimit të afatit të kartonëve të pensionistëve në Komunën Junikut, dhe kërkoj që Komuna ta emëroj një zyrtar për këtë çështje, në mënyrë që pensionistëve të lehtësohet kjo procedurë.

Z. Valdrin Isufaj u ankua se shpjegimi apo raportimi për pikat e shqyrtuara të Rendit të Ditës nga shumica e zyrtarëve komunal është i mangët, sepse nuk japin detaje për asnjë temë apo projekt. Nuk shpjegohet as datat, as afatet e realizimi të këtyre projekteve, ndërsa kërkoj që kjo të ndryshohet në të ardhmen!

Me kaq, kryesuesja znj. Zejnepe Gaxherri e shpalli të mbyllur mbledhjen e sotshme të Komitetit për Komunitete.

Procesmbajtësi,

Kryesuesja e Komitetit për Komunitete,

Gëzim Geci

Zejnepe Gaxherri